



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.145/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Arsim Hamzaj kryesues, Kymete Kicaj e Skender Çoçaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me seli në Prishtinë, paraqitur kundër kandidateve për deputet nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 26.01.2025, merr këtë:

V E N D I M

I. PRANOHEN të bazuara ankesat e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, Anr.145/2025, Anr.148/2025, Anr.149/2025 dhe Anr.150/2025, të datës 23.01.2025

II. Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, i shqiptohet dënimi më gjobë në lartësi prej 6,000.00 (gjashtëmijë) euro.

III. Detyrohet Subjektit Lëvizja Vetëvendosje (LVV), që gjobën e shqiptuar si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

A r s y e t i m

Me datën 23.01.2025 PZAP-i, ka pranuar ankesat e identifikuara me numër Anr.145/2025, Anr.148/2025, Anr.149/2025, Anr.150/2025, nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë. Në ankesën Anr.145/2025, pretendohet se Kandidati për deputet nga radhët e Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), Haxhi Avdyli, ka postuar një video në llogarinë e tij në Facebook me tekst shoqërues e cila ende është aktive, të realizuar në hapësirën e brendshme të Klinikës së Neurokirurgjisë, ku promovon numrin në listën me të cilën kandidon për deputet, si person që mban pozitë publike ka shfrytëzuar këto ambiente me qëllim për përfitim të votave. Poashtu në ankesë pretendohet se me veprimet e tilla janë shkelur dispozitat ligjore të nenit 36, paragrafi 1 i Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet

e Përgjithshme në Republikën e Kosovës-LZP. Në ankesën Anr.148/2025 pretendohet se kandidatja për deputete nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje, znj. Albena Reshitaj, ka publikuar një video në rrjetin social Facebook në ambientet e Kuvendit të Republikës së Kosovës, me qëllim të përfitimit të votave, konkretisht, e njëjta këtë video e cila është realizuar në sallën e Kuvendit të Republikës së Kosovës, përgjatë fjalimit të mbajtur në një nga seancat plenare të Kuvendit të Kosovës, e ka publikuar me tekst përshkrues "Pa kompromis për Republikën! Albena Reshitaj.

Në ankesën Anr.149/2025 pretendohet se më datë 22 janar 2025, kandidati për deputet nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje, z. Agon Batusha, ka publikuar një foto në rrjetin social Facebook, në ambientet e Kuvendit të Republikës së Kosovës, me qëllim të përfitimit të votave, konkretisht, i njëjti këtë foto e ka realizuar në sallën e Kuvendit të Republikës së Kosovës, dhe të njëjtën e ka publikuar me tekst përshkrues "@agonbatusha 74".

Në ankesën Anr.150/2025, me datë 22 janar 2025, kandidati për deputet nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje, z. Besim Muzaqi, ka publikuar një video në rrjetin social Facebook në ambientet e Kuvendit të Republikës së Kosovës, me qëllim të përfitimit të votave, Konkretisht, i njëjti këtë video e cila është realizuar në sallën e Kuvendit të Republikës së Kosovës, përgjatë fjalimit të mbajtur në një nga seancat plenare të Kuvendit të Kosovës, e ka publikuar me tekst përshkrues "Pediatra në spitalin e Mitrovicës 83-shi CEP ME CEP" Kandidatët në fjalë, këto video dhe fot i kanë publikuar me qëllim të promovimit të numrit në listën me të cilën kandidojnë për deputet të cilat janë realizuar në ambientet e Kuvendit të Kosovës, gjithashtu vazhdojnë të jenë aktive në profilet e tyre.

Në përgjigjen në ankesë të datës 25.01.2025, të subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje LVV vlerëson se ankesat e lartcekura janë të pabazuara për faktin se kandidatët në kohën kur kanë bërë fjalimet në Kuvend, ose një ambientet e pediatriisë, në asnjë moment dhe një asnjë fjali, nuk kanë shfrytëzuar institucionin publik për përfitim të votave. Për më shumë, deklaratat përkatëse nga institucionet përkatëse janë realizuar shumë kohë më parë.

Veprimet e tilla nuk sanksionohen nga neni 36 i LZP-së, sepse për faktin se video e shpërndarë nga kandidatët nuk nënkupton prezencën e tyre në institucionin përkatës publik dhe nuk nënkupton shfrytëzimin e institucionit për përfitim të votave.

Bazuar në dispozitën e lartcekur si dhe në praktikën gjyqësore të PZAP-së, për tu sanksionuar një veprim i subjektit politik apo kandidateve përkatës nga ky nen, duhet që personi i tillë, brenda institucionit publik, të përdorë atë zyrë (të jetë prezent) dhe atë ambient të institucionit më qëllim të përfitimit të votave.

Kandidatët në fjalë, nuk kanë shfrytëzuar në asnjë variant institucionin publik për përfitimin e votave. Pra, kandidatët në video, nuk kanë qenë në institucion dhe as nuk kanë bërë fushatë për qëllime përfitimi të votave në kohë fushate. Videot siç vërehet edhe në provat që ka parashtruar parashtruesi, janë realizuar një kohë shumë më të largët dhe ndërlidhur me të, tekstet përkatëse që kandidatët kanë përshkruar në statuse, janë bërë tani, që është në përputhje me legjislacionin zgjedhor. Po ashtu pretendimi se fotografia e cila kinse është realizuar dhe postuar këto ditë (ditët e fushatës) në ambientet e Kuvendit me qëllim të përfitimit të votave, është e pavërtetë dhe e paqëndrueshme për faktin se fotografia e tillë, është postuar më 3 prill 2024 (bashkangjitur në provë), postimi i cili pretendohet se është

bërë nga z. Batusha me qëllimin e përfitimit të votave, është i pasaktë meqë postimi i tanishëm i një fotografie të datës 3 prill 2024, nuk është bërë nga z. Batusha. Pra e njëjta nuk është përdorur nga kandidati dhe nuk është postuar si foto në kohën e fushatës. E njëjta foto arkivë, është postuar nga një person me emrin Lind Basha, i cili e ka përmendur (tagg) Batushën në foto (provë fotografia). Fotot në rrjetet sociale janë publike dhe si të tilla, mund të përdoren nga kushdo, madje edhe nga mediat, përderisa janë publike dhe në këto rast/ personi ka përdorur të njëjtin, mirëpo në asnjë situatë z. Batusha me qëllimin e shfrytëzimit të institucionit publik siç parasheh neni 36 par 1 i LZP-së. Sepse kandidatët kanë të drejtë të bëjnë postime gjatë fushatës zgjedhore.

Andaj, në përputhje me argumentet dhe provat e ofruara, bazuar në dispozitat përkatëse ligjore për zgjedhjet, kanë kërkuar nga Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia që ankesat përkatëse: Anr.145/ 2025, Anr.148/ 2025, Anr.150/2025, të refuzohen dhe të hudhen poshtë si e pabazuara.

Paneli, në kuptim të nenit 9 paragrafi 5, nën paragrafi 5.5 të Rregullores Nr.01/2024, për Procedurat e Parashtrimi dhe Vendosijes së Ankesave të PZAP-it, dhe nenit 84 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031, për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me qëllim të ekonomizimit të procedurës, ka bashkuar ankesat Anr.145/2025, A.nr.148/2025, A.nr.149/2025, A.nr.150/2025 të paraqitura me datë 23.01.2025, dhe janë trajtuar me një vendim, andaj procedimi i këtyre ankesave evidentohen nën shenjë të përbashkët A.nr.145/2025, për shkak të natyrës së njëjtë të çështjeve të parashtruara nga subjekti i njëjtë politik PDK kundër subjektit të njëjtë politik LVV, si për nga përmbajtja ashtu edhe për nga kërkesat e paraqitura të ankesave

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi ankesat gjeti se:

- Ankesat janë të bazuara

Paneli pasi që shqyrtoi pretendimet ankimore dhe përgjigjen në ankesë, ka gjetur se postimi i videos është ende aktiv në llogarinë e facebook-ut, të kandidatëve për deputete nga radhët e Lëvizja Vetëvendosje (LVV), Haxhi Avdyli, Albena Reshitaj, Agon Batusha e Besim Muzaqi, e po ashtu edhe nga prova materiale të bashkangjitur ankesës, së subjektit politik PDK, dhe shkresave tjera të lëndës, paneli ka vlerësuar se nga ana e kandidateve për deputet nga radhët e subjektit politik, Lëvizja Vetëvendosje është shkelur Rregulla Zgjedhore neni 6 i Rregullores Nr. 07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar, pasi që kandidatët në fjalë, me qëllim të promovimit të numrit në listën me të cilën kandidojnë për deputet, janë realizuar në ambientet e Kuvendit të Kosovës dhe njëra në ambientet e Klinikës së Neurokirurgjisë, që sipas vlerësimit të panelit konkludohet se këto intervista shihet se janë bërë vite më parë, por është vërtetuar se në këto postime në rrjetin social facebook shihet numri i kandidatëve të cilët e kanë në këtë fushatë zgjedhore, dhe këto video janë bërë me qëllim të përfitimit të votave dhe këto video janë ende aktive edhe gjatë fushatës zgjedhore, veprim ky i cili bie në kundërshtim me dispozitën e nenit 36 par.1, Ligji Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës parashihet se *“Personi që mban pozitë publike, i zgjedhur apo i caktuar, nuk mund të përdorë at zyrë ose ndonjë nga pasuritë e saj me qëllim të përfitimit të votave.....”*.

Sipas përgjigjes së dhënë në ankesë pretendohet se kandidatet në kohën kur kanë bërë fjalimet në Kuvend, ose një ambientet e neurokirurgjisë, në asnjë moment dhe një asnjë fjali,

nuk kanë shfrytëzuar institucionin publik për përfitim të votave, dhe se videot dhe postimi janë realizuar një kohë shumë më të largët dhe ndërlidhur me të edhe tekstet përkatëse që kandidatët kanë përshkruar në statuse, janë bërë tani, që është në përputhje me legjislacionin zgjedhor, sepse kandidatët kanë të drejtë të bëjnë postime gjatë fushatës zgjedhore. Për më shumë, deklaratat përkatëse nga institucionet përkatëse janë realizuar shumë kohë më parë.

Sipas vlerësimit të panelit veprimet e kandidateve të subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, bie ndesh me dispozitën e nenit 36 paragrafi 1 të LZP-së, e poashtu edhe shkelje të rregullës zgjedhore 07/2024.

Kështu që paneli, me rastin e vendosjes së gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes, pastaj numrin e shkeljeve nga ana e kandidatëve të saj, faktin se dy postime janë tërhequr nga profili i kandidatëve, mirëpo këto veprime të tyre përbëjnë shkelje të legjislacionit zgjedhor. Kjo konsiston në subjekti politik LVV, ka qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës zgjedhore. Andaj përfshirja e videos dhe postimit të fotos për fushatë zgjedhore në ambiente të institucionit, në këtë rast të Kuvendit të Republikës së Kosovës, apo të Klinikës së Neurokirurgjisë, dhe këto veprime përbëjnë shkelje të legjislacionit zgjedhor, saktësisht e sanksionuar me dispozitën e lartcekur të rregullës zgjedhore.

Paneli me rastin e shqiptimit të gjobës ka pasur parasysh edhe praktikën e mëhershme për rastet e ngjashme.

Nga arsyet e theksuara me lart, e në kuptim të nenit 36 paragrafi 1, neni 118 paragrafi 1, neni 120 paragraf 1 nën paragrafi 1.3, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.145/2025 më datën 26.01.2025

Kryesues i Panelit
Arsim Hamzaj



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

AA.nr.17/2025

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Beshir Islami kryetar i kolegjit, Mr.sc. Muhamet Rexha dhe Ragip Namani, anëtarë lidhur, me ankesën e Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 09.02.2025, të paraqitur kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), A.nr.145/2025, të datës 26.01.2025, në seancën e mbajtur më datë 01.02.2025, merr këtë:

A K T G J Y K I M


Refuzohet si e pabazuar ankesa e Subjektit Politik, Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, e paraqitur kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, A.nr 145/2025, të datë 26.01.2025.

A r s y e t i m i

Me vendimin e Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa A.nr.145/2025, të datës 26.01.2025, ishte vendosur "I. Pranohen të bazuara ankesat e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, A.nr. 145/2025, A.nr. 148/2025, A.nr. 149/2025 dhe A.nr. 150/2025, të datës 23.01.2025 II. Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, i shqiptohet dënimi më gjorbë në lartësi prej 6,000.00 (gjashtëmijë) euro. III. Detyrohet Subjektit Lëvizja Vetëvendosje (LVV), që gjorbën e shqiptuar si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

Kundër vendimit të lartpërmendur, Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, në afat të lejuar ligjor ka paraqitur ankesë në Gjykatë Supreme me të cilën e konteston ligjshmërinë e tij për shkak siç thuhet në ankesë, të anulohet vendimi i kontestuar i PZAP A.nr.145/2025, të datë 26.01.2025.

PZAP në përgjigje në ankesën e paraqitur të subjektit Politik, Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, kundër vendimit të tij të lartpërmendur, i kontestoi në tërësi thëniet ankimore



dhe propozoi që ankesa e Subjektit Politik të dënuar me këtë vendim, të refuzohet si e pabazuar ndërsa të vërtetohet vendimi A.nr.145/2025, të datë 26.01.2025.

Gjykata Supreme e Kosovës e vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të kontestuar, në kuptim të pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë, dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave të lëndës, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se më datën 23.01.2025 PZAP-i, ka pranuar ankesat e identifikuar me numër A nr. 145/2025, A nr. 148/2025, A nr. 149/2025, A nr.150/2025, nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë. Në ankesën A nr. 145/2025, pretendohet se Kandidati për deputet nga radhët e Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), Haxhi Avdyli, ka postuar një video në llogarinë e tij në Facebook me tekst shoqërues e cila ende është aktive, të realizuar në hapësirën e brendshme të Klinikës së Neurokirurgjisë, ku promovon numrin në listën me të cilën kandidon për deputet, si person që mban pozitë publike ka shfrytëzuar këto ambiente me qëllim për përfitim të votave. Në ankesën A nr. 148/2025 pretendohet se kandidatja për deputete nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje, znj. Albena Reshitaj, ka publikuar një video në rrjetin social Facebook në ambientet e Kuvendit të Republikës së Kosovës, me qëllim të përfitimit të votave, konkretisht, e njëjta këtë video e cila është realizuar në sallën e Kuvendit të Republikës së Kosovës, përgjatë fjalimit të mbajtur në një nga seancat plenare të Kuvendit të Kosovës, e ka publikuar me tekst përshkrues "Pa kompromis për Republikën" Albena Reshitaj. Në ankesën A nr. 149/2025 pretendohet se më datë 22 janar 2025, kandidati për deputet nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje, z. Agon Batusha, ka publikuar një foto në rrjetin social Facebook, në ambientet e Kuvendit të Republikës së Kosovës, me qëllim të përfitimit të votave, konkretisht, i njëjti këtë foto e ka realizuar në sallën e Kuvendit të Republikës së Kosovës, dhe të njëjtën e ka publikuar me tekst përshkrues "@agonbatusha 74". Në ankesën Anr. 150/2025, me datë 22 janar 2025, kandidati për deputet nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje, z. Besim Muzaqi, ka publikuar një video në rrjetin social Facebook në ambientet e Kuvendit të Republikës së Kosovës, me qëllim të përfitimit të votave, Konkretisht, i njëjti këtë video e cila është realizuar në sallën e Kuvendit të Republikës së Kosovës, përgjatë fjalimit të mbajtur në një nga seancat plenare të Kuvendit të Kosovës, e ka publikuar me tekst përshkrues "Pediatria në spitalin e Mitrovicës 83-shi CEP ME CEP" Kandidatët në fjalë, këto video dhe foto i kanë publikuar me qëllim të promovimit të numrit në listën me të cilën kandidojnë për deputet të cilat janë realizuar në ambientet e Kuvendit të Kosovës, gjithashtu vazhdojnë të jenë aktive në profilet e tyre.


Në përgjigjen në ankesë të datës 25.01.2025, të subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje LVV vlerëson se ankesat e lartcekura janë të pabazuara për faktin se kandidatët në kohën kur kanë bërë



fjalimet në Kuvend, ose një ambientet e pediatriisë, në asnjë moment dhe një asnjë fjali, nuk kanë shfrytëzuar institucionin publik për përfitim të votave. Për më shumë, deklaratat përkatëse nga institucionet përkatëse janë realizuar shumë kohë më parë. Veprimet e tilla nuk sanksionohen nga neni 36 i LZP-së, sepse për faktin se video e shpërndarë nga kandidatët nuk nënkupton prezencën e tyre në institucionin përkatës publik dhe nuk nënkupton shfrytëzimin e institucionit për përfitim të votave. Bazuar në dispozitën e lartcekur si dhe në praktikën gjyqësore të PZAP-së, për tu sanksionuar një veprim i subjektit politik apo kandidateve përkatës nga ky nen, duhet që personi i tillë, brenda institucionit publik, të përdorë atë zyrë (të jetë prezent) dhe atë ambient të institucionit më qëllim të përfitimit të votave.

Paneli, në kuptim të nenit 9 paragrafi 5, nën paragrafi 5.5 të Rregullores Nr.01/2024, për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, dhe neni 84 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031, për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me qëllim të ekonomizimit të procedurës, ka bashkuar ankesat Anr.145/2025, A.nr. 148/2025, A.nr.149/2025, A.nr. 150/2025 të paraqitura me datë 23.01.2025, dhe janë trajtuar me një vendim, andaj procedimi i këtyre ankesave evidentohen nën shenjë e përbashkët A.nr. 145/2025, për shkak të natyrës së njëjtë të çështjeve të parashtruara nga subjekti i njëjtë politik PDK kundër subjektit të njëjtë politik LVV, si për nga përmbajtja ashtu edhe për nga kërkesat e paraqitura të ankesave PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi ankesat gjeti se ankesat janë të bazuara

Paneli pasi që shqyrtoi pretendimet ankimore dhe përgjigjen në ankesë, ka gjetur se postimi i videos është ende aktiv në llogarinë e facebook-ut, të kandidatëve për deputete nga radhët e Lëvizja Vetëvendosje (LVV), Haxhi Avdyli, Albena Reshitaj, Agon Batusha e Besim Muzaqi, e po ashtu edhe nga prova materiale të e bashkangjitur ankesës, së subjektit politik PDK, dhe shkresave tjera të lëndës, paneli ka vlerësuar se nga ana e kandidateve për deputet nga radhët e subjektit politik, Lëvizja Vetëvendosje është shkelur Rregulla Zgjedhore neni 6 i Rregullores Nr. 07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar, pasi që kandidatët në fjalë, me qëllim të promovimit të numrit në listën me të cilën kandidojnë për deputet, janë realizuar në ambientet e Kuvendit të Kosovës dhe njëra në ambientet e Klinikës së Neurokirurgjisë, që sipas vlerësimit të panelit konkludohet se këto intervista shihet se janë bërë vite më parë, por është vërtetuar se në këto postime në rrjetin social facebook shihet numri i kandidatëve të cilët e kanë në këtë fushatë zgjedhore, dhe këto video janë bërë me qëllim të përfitimit të votave dhe këto video janë ende aktive edhe gjatë fushatës zgjedhore, veprim ky i cili bie në kundërshtim me dispozitën e nenit 36 par.1, Ligji Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës parashihet se "Personi që mban pozitë publike, i zgjedhur




apo i caktuar, nuk mund të përdorë at zyrë ose ndonjë nga pasuritë e saj me qëllim të përfitimit të votave.

Sipas vlerësimit të panelit veprimet e kandidateve të subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, bie ndesh me dispozitën e nenit 36 paragrafi 1 të LZP-së, e po ashtu edhe shkelje të rregullës zgjedhore 07/2024.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga gjendja e tillë faktike dhe ligjore e çështjes, e pranon në tërësi si të drejtë dhe të bazuar qëndrimin juridik të PZAP-it, si në vendimin e tij, lidhur me dënimin e subjektit politik Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 09 Shkurt 2025. Vendimi i PZAP është i drejtë i kuptueshëm dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare nga vërtetohet se edhe e drejta materiale është zbatuar drejtë në kuptim të dispozitave ligjore të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, dhe Rregulloren e PZAP-it, për kategorizimin e sanksioneve dhe gjobave të PZAP-it, sepse në mënyrë të sigurt është vërtetuar shkelja nga Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, e Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatet, e paraparë në nenin 36 paragrafi 1, të Ligjit mbi Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe të Rregullores, për Kategorizimin e Sanksioneve dhe Gjobave të PZAP-it. Vendimi i kundërshtuara nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës dhe me zbatim të gabuar të së drejtës materiale.

Objekt shqyrtimi dhe vlerësimi në Gjykatën Supreme ishin pretendimet ankimore të subjektit politik të lartpërmendur, edhe përkitazi me konstatimin jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike ashtu si thekson parashtuesi i ankesës dhe se këto pretendime dhe të tjerat në këtë drejtim nga kolegji i kësaj gjykate refuzohen si të pabazuara dhe jo të qëndrueshme sepse PZAP vendimin e saj e bazon në prova konkrete të qarta dhe ekzistuese duke qenë se përfaqësuesit e Subjektit Politik të gjobitur ishin kandidat për deputet në listën e këtij subjekti, dhe në të gjitha rastet janë përdorur ambientet publike ku kandidatët kishin kryer veprimtari kjo bie ndesh me nenin 36 të LZP i cili parasheh se " 1. Personi që mban pozitë publike, i zgjedhur apo i caktuar, nuk mund të përdorë atë zyrë ose ndonjë nga pasuritë e saj me qëllim të përfitimit të votave. Asnjë nga burimet e asnjë institucioni të administratës publike, qoftë të nivelit qendror ose lokal, ose edhe ndonjë ndërmarrjeje në zotërim ose të kontrolluar nga autoritetet qendrore ose lokale, nuk mund të shfrytëzohen ose të futen në mbështetje të ndonjë subjekti politik në zgjedhje. 2. Gjatë periudhës së fushatës zgjedhore asnjë subjekt politik nuk inkurajon ose përfiton nga nëpunësi publik duke përdorur pozitën publike të tij ose saj për të zhvilluar fushatë për subjektin politik. 3. Me përjashtim



të rasteve të parashikuara me ligj, nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të subjekteve politike në zgjedhje, burime ose resurse të institucioneve apo organeve publike në nivel qendror ose lokal, apo çdo lloj institucioni tjetër publik."

Gjykatës Supreme i rezulton se përdorimi i ambienteve publike ku ata ushtrojnë veprimtari, në kuadër të fushatës zgjedhore, paraqet shkelje të Kodit të Mirësjelljes dhe për këtë arsye e aprovon qëndrimin e PZAP-së lidhur me shkeljen dhe lartësinë gjobës. Kjo për faktin se PZAP-i, me rastin e shqiptimit të gjobës së lartpërmendur, ka marr parasysh një mori rrethanash të precizuara më afër në arsyetimin e vendimit të tij, dhe se lartësia e gjobës e paraparë për një shkelje të tillë sipas nenit 120 paragrafi 1 pika 3, të Ligjit për zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës nr.08-228, është deri në 50.000 €, Gjykata Supreme vlerëson se dënimi i shqiptuar këtij subjekti politik në lartësi prej 6,000.00 €, është i drejtë dhe i ligjshëm, me të cilin vlerësohet se do të arrihet qëllimi ligjor i tij, jo vetëm ndëshkimi i shkelësve të dispozitave të Kodit të Mirësjelljes të subjektit politik, mbështetësve dhe kandidatëve të tyre, por edhe korrektimi i shkeljeve të ndryshme zgjedhore dhe sigurimi i mbarëvajtjes së këtyre dhe zgjedhjeve të tjera, si dhe ndikimi edhe në subjektet e tjera politike që garojnë në zgjedhje, që me përpikëri të zbatojnë dispozitat e Ligjit mbi Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës. Duke u nisur nga fakti se gjoba i referohet më shumë rasteve të konstatimit të shkeljes dhe shumës së gjobës së shqiptuar, Gjykata Supreme e Kosovës konsideron se kjo është në përputhje me ligjin dhe praktikën e kësaj gjykate.

Nisur nga gjendja faktike e vërtetuar, kjo Gjykatë konstatoi se në këtë çështje juridike, gjendja faktike është vërtetuar drejt dhe nuk është shkelur ligji në dëm të parashtruesit të ankesës, prandaj, pretendimet në ankesë lidhur shkeljen e Kodit dhe me gjobën e shqiptuar u refuzuan si të pa bazuara sepse si të tilla nuk dëshmuuan se përmbushin shkaqet për të cilat mund të paraqitet ankesa që të prezantohen fakteve të reja nga pala e interesuar dhe, nuk u gjetën shkelje procedurale e as ndonjë gabim faktik i cili ndikon në të drejtat e palës apo ligjshmërinë e procedurës.

Nga theksimet si më lartë dhe në bazë të nenit 118 paragrafi 4, 120 paragrafi 1 pika 1.3 dhe 36 paragrafi 1, të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

AA.nr.17/2025, datë 01.02.2025.



Republika e Kosovës



Republika Kosovo

SAKTËSINË E KOPJËS E VËRTETON
TAČNOST OTPRAVKA POTVRDJUJE

Kryetari i kolegjit,

Beshir Islami

Punëtori i autorizuar
Ovlašćeni radnik



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLICA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVA
KËSHILLA GJYQËSOR E KOSOVËS/ SUBSKI SVETI KOSOVA/ KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



SEKRETARIATI I KËSHILLIT GJYQËSOR TË KOSOVËS

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

FLETËDËRCESË PËR DORËZIM PERSONAL DOSTAVNICA ZA LICNO DOSTAVLJANJE

Shëjti i shkresës _____

Oznaka spisa: _____

AA-17/2025
04.02.2025

1. Pasi marrësi, i cili me tënimin e parë të dorëzimit nuk u gjat në vendin e ku është dëshitë të bëhet dorëzimi i sa pas tënjës së ligjshmit me shkrim që për shkak të dorëzimit të gjendet në kohën e caktuar në bancesën apo në vendin e punës, së tij, dorëzimi është bërë; anëtarit madhor të familjes së marrësit - kujdestarit të ndërkësës, fighur, personit që punon po në atë vend me marrësin.

1. Posto prinitiac, koji pri prvom pokušaju dostave nije zatecen na mestu gde se dostavljanje ima izvršiti ni posle ostavljenog pismenog obavještenja da radi dostavljanja bude u određenom vrenu u svom stanu radnom mestu, dostava je izvršena; odraslom članu domaćina. Prinitoca nastojniku zgrade susedu licu zaposlenom na istom radnom mestu primaocem

2. Pasi marrësi ose anëtar i familjes së tij e refuzon marrjen e shkresës, shkresa u la në bancesë në vendin e punës së marrësit (duke e ngjitur në detyrë e bancesës ose të lokalit ku gjendet në punë marrësi).

2. Posto prinitiac odnosno član njegov domaćinstva odbio prijem, pismo je dostavljeno u stanu - radnom mestu primaoca (priblieno na vratima stana odnosno prostorije gde prinitiac zaposlen)

Më _____ 201 _____ në ora _____ cas.

Shkak i refuzimit të marrjes _____

Razlog odbijanja prijmea _____

Nënshkrimi i dorëzuesit - potpis dostavljaoca

Numri i shtojcave: _____
broj priloga

AA-17/2025 01 02 2025

Emri i shkresës që dorëzohet:
Naslov pisma koja se dostavlja:

Vërtetoi se mora shkresën e lartpërmendur
më (me fjalë)
Povrđujeno prijem gorenavenog pisma
(i slovima)

(Nënshkrimi i marrësit ose i atij që
e ka marrë aktin në vend të tij
Potpis primaoca ili lica koje je
pismeno primilo u zameni)

AA-17/2025 01 02 2025

Nënshkrimi i dorëzuesit - potpis dostavljaoca

Në rast se marrësi është analfabet ose nuk është në gjendje të nënshkruajë dorëzuesi, duke shënuar shkaku pse marrësi nuk e ka vënë nënshkrimin e vet. Ako je prinitiac nepismen ili nije u stanju da se potpiše, potpisuje ga dostavljaoc, napomenom zasto prinitiac nije stavio svoj potpis.